



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201800185/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2018

**Lënda:** Rekomandim për marrjen e masave për përmirësimin e kushteve në Qendrën Polivalente Poliçan.

**Drejtuar:** Z. Adriatik Zotkaj  
Kryetar i Bashkisë

**POLIÇAN**

Znj. Luneda SUFALI  
Drejtoreshë e Përgjithëshme e Shërbimit Social Shtetëror

**TIRANË**

**Për dijeni:** Znj. Mirela PËRROJ  
Drejtoreshë e Qendrës Polivalente

**POLIÇAN**

***Te nderuar,***

Në përmbushje të detyrave kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të të drejtave të njeriut, përfaqësues të Institutionit të Avokatit të Popullit, më datë 29.01.2018, kanë inspektuar Qendrën Polivalente Poliçan.

Ky inspektim u krye në mbështetje të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet ndër të tjera se: "Avokati i Popullit ose persona të autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim apo autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në azile dhe vecanerisht në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër ku ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut".

"Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime

*inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise”.*

### ***Profili i instucionit***

Qendra Polivalente Poliçan është nën administrimin e Bashkisë Poliçan dhe mbështetja financiare garantohet nga programet e mbrojtjes sociale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror<sup>1</sup>.

Në takimin e bërë me drejtuesen e institucionit, u informuam se kjo qendër, ku janë sistemuar përfituesit, është rikonstruktuar në vitin 2010 nga fondet e projektit të Bankës Botërore “*Shpërndarja e shërbimeve shoqërore*”. Aty strehohen dhe trajtohen 38 të moshuar, së bashku me 6 të moshuar të transferuar nga Shtëpia e të Moshuarve Shkodër, deri në përfundim të rikonstruksionit të godinave të saj. Dy të moshuar janë sistemuar nga Bashkia Poliçan. Kapaciteti i përfituesve në këtë qendër është për 40 persona. Përfitues të pensionit të pleqërisë janë 22 të moshuar, të cilët nuk shprehën asnjë shqetësim lidhur me menaxhimin e tij nga punonjësja e financës.

Personeli i kësaj qendre përbëhet nga 13 punonjës. Dosjet origjinale të personelit mbahen në Bashkinë Poliçan, ndërsa fotokopjet pranë kësaj qendre. Por ajo që u konstatua ishte fakti se për 9 punonjës të emëruar nga Bashkia Poliçan, me kohë të pjesshme, dosjet e tyre nuk ndodheshin në këtë qendër.

Organizimi dhe funksionimi i kësaj qendre së bashku me përshkrimet e punës, të drejtat dhe detyrimet e përfituesve, janë të parashikuara në Rregulloren e Brendshme.

Me problemet psiko-sociale të të moshuarve merrej një punonjëse sociale dhe pesë kujdestarë dhe për vlerësimin e tyre kishte dosje sociale. Gjithashtu çdo i moshuar kishte dosjen e tij personale, në të cilën ishte shënuar plani shëndetësor sipas nevojave të të moshuarve, i cili hartohej nga mjeku, kujdestari dhe punonjësi social. Çdo i moshuar kishte kartelën mjekësore të mjeku i familjes në Qendrën Shëndetësore Poliçan.

Shërbimi mjekësor realizohej nga një mjekë me kohë të pjesshme dhe nga një infermiere, e cila në organikë është në pozicionin e kujdestares.

Kuota ushqimore është 300 lekë në ditë për çdo të moshuar. Kampionët e ushqimeve ruhen në frigorifer. Për ushqimin dhe përcaktimin e menisë si dhe të vakteve të ngrënies merret mendimi i të moshuarve.

---

<sup>1</sup> -Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.451 datë 15.06.2016 “*Për transferimin në pronësi, nga Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror të Bashkia Poliçan, të Qendrës Polivalente për Shërbime të Përkujdesit Shoqëror dhe për një ndryshim në Vendimin nr.1324 datë 01.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Shëndetësisë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, të ndërtesës së ish-Spitalit Poliçan” dhe një ndryshim në Vendimin nr.60 datë 01.02.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Social Shtetëror”* .

-Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.542 dt.27.7.2005 “*Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror*”, i ndryshuar.

-Ligji nr.121/2016 “*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*”

Stafi i qendrës është trajnuar në vitin 2017 nga Kryqi i Kuq për dhënie të ndihmës parësore për të moshuarit dhe në përfundim janë pajisur me çertifikata.

### ***Ambjentet e institucionit***

Në katin e parë të ndërtesës ndodhet menca, kuzhina dhe magazina. Në katin e dytë ndodheshin zyrat e administratës si dhe pesë dhoma për të moshuarat femra. Në dy dhoma jetonin nga dy të moshuara dhe në tre të tjera nga tre të moshuara. Vetëm dy nga këto dhoma ishin me tualet brenda.

Në katin e tretë dhe të katërt ndodheshin dhomat e të moshuarve meshkuj (13 dhoma). Gjithashtu në katin e tretë ndodhej dhe lavanderia. Në çdo kat kishte vetëm dy dhoma me tualet, ku ishin sistemuar të moshuarit, të cilët ishin më të rënduar nga ana shëndetësore. Për të moshuarit e tjerë tualetet janë të përbashkëta dhe shpesh kjo krijon problem për ta. Në ambiente të veçanta ishin vendosur standartet e shërbimeve sociale, që duhet të respektonin punonjësit e qendrës.

Kutia e ankesave ishte vendosur në ambient të aksesueshëm për të gjithë përfituesit. Hapja e kutisë realizohej një herë në muaj nga komisioni, i cili përbëhet nga një përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Berat, punonjësjë sociale dhe një i moshuar.

Mjetet për shmangien e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në korridore. Godina ka shkallët e emergjencës për evakuimin e përfituesve dhe të stafit.

Me furnizimin e artikujve hotelerike nuk kishte probleme. Ky furnizim realizohej me anë të tenderimit, por edhe nga donacione. Konkretisht, së fundmi, 20 krevate të reja, të përshtatura për të moshuarit (spitalore), ishin dhuruar nga një vajzë nga Poliçani, e cila jetonte në Belgjikë.

Të moshuarve, të cilët ishim me probleme shëndetësore, ushqimi u servirej nëpër dhomat e tyre. Ata ishin të kënaqur me cilësinë e ushqimit si dhe vlerësonin faktin se çdo ditë u ndërroheshin çarçafët.

Në këtë godinë ishte i vendosur një ashensor, por që nuk ishte në përdorim për arsye të humbjes së çelësit.

Në kuzhinë kishte sobë industriale, e cila ishte në gjendje të mirë pune si dhe një frigorifer. Në lavanderi kishte tre lavatriçe jo industriale, nga të cilat vetëm dy ishin në gjendje pune. Nga drejtuesja e qendrës u informuam se nga organizata “Schnell”, Tiranë, do u dhurohet një lavatriçe industriale. Gjithashtu kishte dhe një tharëse rrobash, e cila ishte në gjendje të mirë pune.

Sistemi i ngrohjes dhe i ftohjes realizohet me kaldajë dhe me korent.

Në ambientet e institucionit kishte ujë të rrjedhshëm. Uji i ngrohtë mundësohej nga vendosja e paneleve diellore, projekt i UNDP-së në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror.

Brenda territorit të qendrës ndodhej dhe një godinë e pabanueshme, e cila ishte pjesërisht e rikonstruktuar.

Duke qenë se oborri përreth qendrës ishte relativisht i madh dhe e pamundur për t'u mirëmbajtur nga sanitaret e qendrës, ajo pastrohej nga punëtorët e Bashkisë Poliçan, të cilët siç u shprehëm më lart, punonin me kohë të pjesshme.

### ***Jeta social-kulturore***

Përsa i përket jetës sociale, organizoheshin aktivitete të ndryshme, datëlindje, festa zyrtare etj. Të moshuarit marrin pjesë në aktivitete kulturore që organizohen në Poliçan.

Ata të moshuar, të cilët kanë të afërm, vizitohen herë pas here nga to. Për takimet e zhvilluara, mbahet një proces-verbal nga përgjegjësit e turnit. Ka një regjistër Tip për vizitat e kryera, ku regjistrohen emrat e familjarëve apo të të afërmeve dhe mbahet një proces –verbal, i cili firmoset nga kujdestarët dhe vizitorët.

Në qendër organizohen aktivitete me tematika të ndryshme me nxënës nga shkollat e qytetit të Poliçanit dhe Beratit.

Në kuadrin e shkëmbimit të eksperiencave, janë zhvilluar bashkëpunime ndërinstucionale me Shtëpitë e të Moshuarve.

Zbatimi i standardeve të shërbimeve sociale monitorohet një ose dy herë në vit nga Bashkia Berat, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Berat, nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimit Social, Agjensia Kombëtare e Ushqimit dhe nga Drejtoria e Higjienës, Berat .

Nga intervistat e realizuara me të moshuarit, ata shprehën konsideratën ndaj stafit të qendrës dhe nuk paraqitën ankesa, përveç të moshuarit Muharrem Kurti, i cili pretendonte se mjekja, e cila punon me kohë të pjesshme nuk vjen çdo ditë në këtë qendër.

#### **Gjatë këtij inspektimi u konstatuan problematikat e mëposhtme:**

- Në organikën e punonjësve të qendrës janë 5 kujdestarë, të cilët punojnë me tre turne, e papërbalueshme që një apo dy kujdestarë ofrojnë shërbime gjatë një turni, duke patur parasysh faktin se kjo kategori ka shume probleme sociale dhe shëndetësore.
- Ka vetëm një infermiere, e cila nuk e ka këtë pozicion sipas organikës të kësaj qendre dhe njëkohësisht kryen edhe punën e kujdestares. Ka të moshuar të sëmurë, të cilët bëjnë rregullisht injeksione një ose dy herë në ditë dhe kjo gjë i detyron të marrin këtë shërbim në Qendrën Shëndetësore të qytetit të Poliçanit, ndërkohë që sipas standarteve një infermiere duhet të jetë për çdo 12 të moshuar, e cila ofron edhe shpërndarjen e ilaçeve sipas porosive të mjekut.
- Një problem shqetësues është edhe ajo e mjekut me kohë të pjesshme, pasi të moshuarit janë me probleme shëndetësore të ndryshme dhe kanë nevojë që mjeku të jetë i pranishëm në qendër me kohë të plotë.
- Në këtë qendër ka të moshuar me probleme mendore, që kanë nevojë për asistencën e një psikiatri si dhe për të gjithë të moshuarit e tjerë për asistencën e një psikologu.
- Nuk janë të depozituara fotokopje të dosjeve të personelit të emëruar së fundmi (9 punonjësit e Bashkisë) në këtë qendër, në përmbushje të detyrimeve për ruajtjen e dokumentacionit të personelit.
- Nuk janë kryer trajnime për stafin nga Bashkia Poliçan dhe Shërbimi Social Shtetëror, në zbatim të standartit për kualifikimet e duhura për shërbimet që u janë ngarkuar të kryejnë.
- Nuk është trajnuar stafi për përdorimin e pajisjeve kundër zjarrit, pavarësisht kërkesave të bëra për këtë qëllim.
- Gjithashtu si një problem imediat është edhe mospasja e një mjete transporti në dispozicion, jo vetëm për raste emergjente apo transportimin e të moshuarve për vizitat e shpeshta mjekësore në Poliçan apo Berat, por edhe për zhvillimin

- e aktiviteteve të ndryshme, duke patur parasysh faktin e vendndodhjes së kësaj ndërtese, e cila është në periferi të qytetit të Poliçanit dhe vendi është malor.
- Kuota ditore ushqimore për çdo të moshuar në vlerën e 300 lekëve nuk është e mjaftueshme. Kjo vlerë nuk ka ndryshuar prej disa vitesh, pavarësisht rritjes së çmimeve të mallrave ushqimore.
  - Rregullorja e qendrës nuk ishte e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Poliçan.
  - U evidentua lagështirë në tualetin e katit të tretë të godinës.
  - Rruga përpara hyrjes për në këtë qendër ishte e pa shtruar, gjë që krijonte vështirësi në lëvizje për të moshuarit dhe jo vetëm.
  - Nuk kishte ambjente pushimi për të moshuarit, pavarësisht hapësirës së madhe të oborrit. Nuk kishte të vendosur asnjë stol apo të krijoheshin kende të veçanta për të kaluar kohën të moshuarit .

Nga konstatimet e mësipërme, Avokati i Popullit gjykon se pavarësisht punës së bërë në këtë qendër, kërkohet një angazhim për një bashkëpunim ndërinstitucional ndërmjet pushtetit qëndror dhe atij vendor, me qëllim përmbushjen e standarteve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në institucionet rezidenciale, të cilat bazohen mbi parimet e njohura të kujdesit social si: respektimi i vlerave dhe individualitetit, universaliteti, barazia e mundësive, e drejta për të përfituar, partneriteti, transparenca dhe paanshmëria, mosdiskriminimi, integrimi shoqëror, pavarësia dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit.

Sa më sipër, për t’iu përgjigjur sa më shumë nevojave të të moshuarve në këtë qendër dhe në plotësim të standardit të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në Institucionet Rezidenciale, siç është pasurimi i rrjetit të shërbimeve dhe rritja e cilësisë së tyre, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

## **REKOMANDOJMË:**

Marrjen e masave për:

1. Shtimin në organikë të pozicioneve të punës me kujdestarë, mjek me kohë të plotë, infermiere, psikiatër dhe psikolog.
2. Miratimin e Rregullores së Brendëshme të Qendrës Polivalente Poliçan.
3. Mundësinë e vënies në dispozicion të një mjeteve transporti.
4. Trajnimi i stafit për zbatimin e standarteve të përkujdesit social për të moshuarit si dhe për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit.
5. Rritjen e kuotës ushqimore ditore, minimalisht në 350 lekë në ditë.
6. Dërgimin e kopjeve të dokumentacionit të dosjeve të personelit të Qendrës Polivalente nga Bashkia Poliçan.
7. Rikonstruksionin e tualetit të katit të tretë.
8. Vënia në funksionim i ashensorit.
9. Asfaltimin e rrugës përpara hyrjes në këtë qendër.
10. Përshtatja e hapësirave të caktuara të oborrit për krijimin e ambjenteve rekreative për të moshuarit.
11. Mundësinë e ngritjes së një qendre ditore për njerëzit në nevojë në godinën e dytë

brenda territorit të qendrës, për t'i ardhur në ndihmë komunitetit.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar : *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”*.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj, mbetemi në pritje të përgjigjeve për qëndrimin ndaj rekomandimeve të sipërcituara.

**K O M I S I O N E R**

**Ermir KAPEDANI**